

Pergjigje No:3

Bazuar në kërkesën tuaj datë 13.07.2021 (administruar nga AKEP datë 14.07.2021), me anën e së cilës kërkonti informacion për identifikimin dhe mbylljen faqeve online të lojrave të fatit, ju bëjmë me dije sa më poshtë:

Në bazë të nenit 2, të Ligjit nr. 9918/2008 për komunikimet elektronike, i ndryshuar, AKEP nuk ka tagër të shqyrtojë përmbajtjen e komunikimeve elektronike, pra as të faqeve të internetit, përfshirë faqet online të lojrave të fatit, për pasojë nuk ka tagër as të gjykojë nëse u duhet bllokuar apo kufizuar aksesit.

Institucioni vendimmarrës për kufizimet në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme, të faqeve të lojrave të fatit, është Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit (AMLF).

Ndërfaqen komunikative midis AMLF dhe sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve elektronike, AKEP e kryen prej hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 47, datë 26 tetor 2017, “Për zbatimin e autorizimit të përgjithshëm” dhe në përputhje me nenin 15, të ligjit 9918/2008, i ndryshuar.

AKEP, për sa parashikohet më sipër, vepron në mbështetje dhe për të lehtësuar komunikimin mes organeve vendimmarrëse të këtyre kufizimeve (në këtë rast AMLF) dhe sipërmarrësve subjekt të ligjit 9918/2008. Për këtë arsye, dhe në kuadër të transparencës institucionale, çdo shkresë përcjellëse të AKEP në adresë të sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve elektronike, i bashkëlidhet vendimi i organit përkatës.

Gjatë të viteve të fundit, AMLF ka kërkuar kufizime të aksesit të domaineve/faqeve të lojrave të fatit, për rreth 8000 domaine/faqe në vitin 2019, për 132 domaine/faqe në 2020 dhe për 41 domaine/faqe në 2021, deri në datën e kësaj përgjigje.

Në çdo rast, ISP-të kanë shprehur bashkëpunim dhe kanë kufizuar aksesin e domaineve/faqeve të lojrave të fatit. Verifikimi i kufizimit të aksesit nga ISP-të, është pjesë e veprimtarisë së inspektimeve që kryhen çdo vit nga AKEP dhe nga këto inspektime ka rezultuar që ISP-të e inspektuara, i kanë kryer kufizimet e kërkuara nga AMLF.

Duke ju falenderuar,